



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS : REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË : OPËTINA VITINA

Pranuar - Prilajens Meqëna 30-05-2014			
Nr. i organit Org. broj	Num. i organit	Shtetësi	Vlera
01-013/265			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 36 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 27.05.2014, aprovon këtë:

V E N D I M

PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË VITISË
PARCELËN NR 3624-1 ME PARCELAT NR 3393-5 DHE NR3392-2 NË PRONËSI PRIVATE

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, LEJON që të bëhet këmbimi i pjesës së parcelës kadastrale të evidentuar me nr.3624-1 e cila është pronë e Komunës së Vitisë me parcelat kadastrale nr 3393-5 me sipërfaqe 12m² dhe nr.3392-2 me sipërfaqe prej 62 m² Zona Kadastrale Viti, të cilat janë në pronësi të Ridvan (Isuf) Sallahut nga Kabashi.

Neni 2

Për parcelat kadastrale të shënuara në nenin 1 të këtij vendimi, është shpall interesi i përgjithshëm nga Kuvendi i Komunës së Vitisë me qëllim të zgjerimit të rrugës Viti- Kabash (te kthesa e madhe në hyrje të fshatit Kabash).

Neni 3

Parcelat të cilat do të këmbehen do ti hyjnë procesit të vlerësimit nga Zyra për Vlerësimin e pronës së paluajtshme në kuadër të Departamentit të Tatimit në Pronë pranë Ministrisë për Financa.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër Pronë dhe Gjeodezi, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe Drejtoria e Inspektionit e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit,
2. Drejtorisë për Kadastër
3. Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
4. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

